



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI

Nr. 3582 prot.

Gramsh, më 28/09/2021

**URDHËR**

Nr. 211, datë 28/09/2021

**“PËR RIKTHIM NË TË NJËJTIN POZICION PUNE, PAS PËRFUNDIMIT TË LEJES SË LINDJES”**

Në bazë të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8/2, neni 9/1.1 pika “b”; Ligjit nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ (i ndryshuar); Vendimit Nr.95, datë 28.12.2020 “Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh, për vitin 2021” të këshillit bashkiak; Vendimit nr.98, datë 18.06.2021 “Për një ndryshim të vendimit nr.24, datë 11.02.2021 “Për miratimin e strukturës organizative për Bashkinë Gramsh dhe Njësive në varësi të saj, për vitin 2021” të kryetarit të bashkisë; Vendimit nr.35, datë 21.03.2016 “Për emërim punonjësi në shërbimin civil” të kryetarit të bashkisë; Urdhërit nr.319, datë 27.10.2020 “Për përfitim të lejes së lindjes” të kryetarit të bashkisë, përfundimit të raportit për leje barrë lindje, kërkesës nr.3459, datë 17.09.2021 “Kërkesë për rikthim në punë”,

**URDHËROJ:**

1. Zj.Elisabeta Xhepexhiu, nëpunës pranë Bashkisë Gramsh, deri tani me leje lindje, e zëvendësuar nga punonjësi Erionilda Miraka, pas përfundimit të raportit për barrë lindje, të rikthehet në të njëjtin pozicion pune si “Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Sociale” në Drejtorinë e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar;
2. Marrdhëniet efektive dhe ato financiare t’i fillojnë më datë 30.09.2021;
3. Nëpunësi të paguhet me element page:PG+(2%XPG)+SHP, PG=14000, SHP=49000 vjetërsi= 9 vjet;
4. Punonjësit ti vihet zyrtarisht në dispozicion një kopje e këtij Urdhëri nga Sektori Arkivës, kundrejt nënshkrimit të tij;
5. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori i Menaxhimit Financiar, për të bërë raportimet përkatëse në sistem në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

